



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:187296
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06341731

C.nr.2017/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike civile të paditësit-kundër i padituri I.G nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av. Flamur Abdullahu nga Prishtina, kundër të paditurit-kundër paditësi F.B dhe N.C.H.L L.L.C. me nr. të biznesit me seli në Ferizaj që i përfaqëson av. Agim Demiri nga Ferizaj, me objekt kontesti sipas padisë vërtetim pronësie dhe objekt kontesti sipas kundërpadisë pasurimi i pa bazë juridike, jashtë seancës me datë 24.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr kundërpadia e të paditurit- kundër paditësit F.B nga Ferizaj ndaj paditësit-kundër te paditurit I.G nga Ferizaj me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri I.G nga Ferizaj i cili është pasuruar pa bazë juridike në dëm të paditësit F.B nga Ferizaj ashtu që të ja kompensoj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 1,980.00 euro në emër të tatimit për qira në lartësi prej 9%, si dhe në emër të borxhit shumë prej 10 mijë euro për qiranë e pa paguar nga ana e të paditurit I.G për shfrytëzimin e lokalit afarist i cili gjendet në njësinë kadastrale në kuadër të objektit të N.C.H.L LLC, me seli ne Ferizaj, parcela kadastrale ... ZK Ferizaj.

A r s y e t i m

Paditësi-kundër i padituri I.G nga Ferizaj të cilin e përfaqëson av. Flamur Abdullahu nga Prishtina ka paraqitur në këtë gjykatë më dt. 29.12.2020 padi, kundër të paditurve F.B dhe N.C.H.L L.L.C. me nr. të biznesit me seli në Ferizaj që i përfaqëson av. Agim Demiri nga Ferizaj, me objekt kontesti sipas padisë vërtetim pronësie.

Me datë 09.03.2021 i padituri- kundërpaditësi F.B nga Ferizaj të cilin e përfaqëson av. Agim Demiri nga Ferizaj kanë paraqitur kundërpadi ndaj, paditësit- kundër të paditurit I.G me objekt kontesti pasurimi i pa bazë juridike.

I padituri-kundërpaditësi përmes të autorizuarit të tij av. Agim Demiri nga Ferizaj, i kanë dorëzuar gjykatës me dt. 27.05.2024 parashtresë në të cilën theksojnë se e tërheqin kundërpadinë ndaj paditësit-kundër të paditurit.

Gjykata ja ka dorëzuar përfaqësuesit të paditësit av. Liridon Jetishi nga Ferizaj në seancën e dt. 27.05.2024, parashtresën e të paditurit-kundërpaditësit për tërheqjen e kundërpadisë, por i njëjti brenda afatit ligjor nuk është deklaruar lidhur me këtë parashtresë, andaj konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e kundërpadisë.

Prandaj gjykata me aplikimin e nenit 261.2 të LPK lidhur me nenin 381.1, pika c) të LPK dhe 256 të LPK e ka konstatuar të tërhequr kundërpadinë e të paditurit-kundërpaditësit.

Nga të gjitha të lartcekurat, e konform nenit 142 të LPK u vendosë si në dispozitiv.

Gjykata Themelore në Ferizaj

C.nr.2017/20, datë 24.10.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK.